



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Konkursi Mbarëkombëtar i Krijimtarisë Muzikore në gjinitë: Opera, Balet dhe Muzikal

2018-04-11 17:17:00



Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të vitit 2018, shpallur nga qeveria shqiptare “Viti mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor , me përparësi për të aftësuar kapacitetet krijuese për artistë me ide inovative që i duan sfidat, shpall organizimin e Konkursit Mbarëkombëtar të Krijimtarisë Muzikore në gjinitë: Opera, Balet dhe Muzikal.

Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të vitit 2018, shpallur nga qeveria shqiptare “Viti mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor , me përparësi për të aftësuar kapacitetet krijuese për artistë me ide inovative që i duan sfidat, shpall organizimin e Konkursit Mbarëkombëtar të Krijimtarisë Muzikore në gjinitë: Opera, Balet dhe Muzikal.

Ky konkurs synon të zhvillojë krijimtarinë muzikore dhe të nxjerrë në pah talentin, artin dhe frymëzimin e artistëve në këto gjini dhe kërkon të inkurajojë artistët në këto gjini të muzikës skenike, duke promovuar kreativitetin, afirmimin dhe dialogun në botën emocionuese të Muzikës, në një konkurs mbarëkombëtar.

Mirëpresim aplikime nga krijues shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, veprat e të cilëve do të interpretohen në format koncertal brenda muajit dhjetor 2018.

Produksionet e plota të vlerësuara fituese do të përfshihen në kalendarin artistik të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor.

Data të rëndësishme

11 Prill 2018: Hapja e Thirrjes Publike;

11 tetor 2018: Afati i dorëzimit të veprës;

31 tetor 2018: Vlerësimi dhe seleksionimi i veprave nga juria;

10 dhjetor 2018: Pjesë nga veprat premierë të kualifikuara për eventin final koncertal për publikun dhe dhënia e çmimeve nga Juria;

Viti 2019-2020: Realizimi i plotë skenik i veprave fituese të vlerësuara me çmim.

Bashkëlidhur gjeni dokumentat e aplikimit

[Deklarata e të drejtës së autorit](#)

[Kriteret per Konkursin e Krijimtarise Muzikore 2018](#)